



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 886 Prot.

Tiranë, më datë 1.7.2022

**VENDIM**  
**Nr. 359, datë 01.07.2022**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 01.07.2022:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e “Raportit të rezultateve të sondazheve arkeologjike relaizuar nga individ i licencuar në arkeologji Luan Përzhita për projektin “Rindërtimi i Shkollës “Gjergj Kastrioti” Durrës” Zona Arkeologjike ‘B’ Durrës, me aplikues Metro-Polis dhe zhvillues Bashkia Durrës;
  2. Të zgjerohet sondazhi arkeologjik, për evidentimin e strukturave të murit, sipas rekomandimeve të z. Luan Përzhita, në raportin e rezultateve të sondazheve arkeologjike;
  3. Vijimin e punimeve në pjesën tjetër të sheshit të ndërtimit, duke lidhur akt-marrveshje 3-palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, për monitorimin arkeologjik;
  4. Gjatë procesit të zbatimit, nëse ndeshen gjetje arkeologjike rastësore, në zbatim të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 145-147, punimet të ndërpriten menjëherë dhe të raportohet pranë IKTK-së;
  5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
  6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETAR**  
**Rudina ZOTO**

**KRYETAR**  
**Elva MARGARITI**

